



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1171 Prot.

Tiranë, më datë 01.12.2020

VENDIM
Nr. 442, datë 01.12.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.12.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e fazës së projekt idesë: “Ndërhyrje Përforcuese dhe Rehabilituese në 9 objekte institucione publike në Bashkinë Tiranë, “Arkiva Qendrore Shtetërore e Filmit” me aplikues Rais Petrela dhe projektues ARCHISPACE;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elva MARGARITI

SEKRETAR
Arta DOLLANI

Arta
Dollani

Digitally signed by Arta
Dollani
DN: c=AL, o=Instituti i
Memorieteve të Kulturës,
title=Drejtor i Përgjithshëm,
cn=Arta Dollani
Date: 2020.12.01 19:03:16
+01'00'

Elva
Margariti

Digitally signed
by Elva Margariti
Date: 2020.12.01
19:20:17 +01'00'